



**Republika e Kosovës**

**Komuna e Drenasit**

**Kuvendi i Komunës**



**12 Nr. 060-49757 dt. 26.08.2019**

### **PROCESVERBALI**

**I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 19.07.2019, ora 10<sup>00</sup>.**

**Mbledhjen e kryesoi Labinot Halilaj-Kryesues.**

**Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për politikë dhe financa ku të pranishëm ishin anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Gani Podrimqaku, Blerina Gashi, Florentina Elezi, Fitore Morina, Edolina Plakiçi, Burim Bujupi.**

Komiteti filloi punimet më këtë:

### **Rend dite:**

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 20.06.2019
2. Propozim vendim për ridestininim dhe transfer të mjeteve nga kategoria e projekteve kapitale dhe kategoria për mallra dhe shërbime në shpenzime kapitale.
3. Propozim vendim për ridestininim të mjeteve nga Drejtorati për infrastrukturë Publike.
4. Propozim vendim për formimin e Panelit përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Barazi Gjinore.
5. Propozim vendim për formimin e komisionit për plotësim/ndryshimin e Rregullores për subvencione të Komunës së Drenasit.
6. Raporti financiar i zhvillimit të buxhetit Janar - Qershor 2019.
7. Plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve të raportit për vitin 2018.
8. Propozim vendim për financimin e projektit Handikos Drenas.
9. Të ndryshme.

**Prezent gjatë mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa ishin, Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, drejtorë të drejtorive përkatëse dhe përfaqësuesit e OSCE-së.**

**Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj:** Besoj se jeni të informuar me pikat e rendit të ditës. Atëherë vijojmë me pikat e rendit të ditës, ndërkohë që ju kemi përcjell dy pika të tjera, që është Plani i implementimit të rekomandimit të raportit të vitit 2018 dhe Propozim vendimi për financimin e projektit Handikos Drenas. Para se të kalojmë në votim, a ka ndonjë propozim? Po drejtor.

**Drejtori i Drejtorisë për Infrastrukturë Idriz Hysenaj:** E kemi prurë një material për regjistrimin e mjeteve, ndërkohë kemi lidhur një kontratë e bëjmë një shtesë tek pika numër tre, përcjellim materialin dhe duhet veç me u shtu si pikë më vete, që u lidh kontrata.

**Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj:** Po dakort, a ka ndonjë gjë tjetër? Po Burim

**Burim Bujupi:** Pasi zyra kombëtare e auditimit e ka nxjerr raportin në qershor kur na keni bërë thirrje për këtë mbledhje është dasht me na i dhënë më përpara materialet e raportit që të kishim mundësi për të nxjerrë të dhëna.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci:** Burim mund me pas të drejtë, po raporti është publik në vebfaqe të Kuvendit është për të gjithë. Raporti është mirë me e çu në mbledhje me e diskutu Kjo është Komitet dhe kur merreni vesh këtu në kuvend ka me u diskutu nga të gjithë asambleistat. Raportin e kemi një nga më të mirat që kanë komunat e Kosovës.

**Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj:** Atëherë, pasi nuk ka diskutime, vërejtje, apo sugjerime kalojmë në aprovimin e Rendit të ditës. Votojmë;

**7për, kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.**

**Kalojmë tek Pika e parë; Proces verbali i mbledhjes së kaluar?**  
**Ka ndonjë sugjerim? Po Burim.**

**Burim Bujupi:** Një vërejtje të vogël në shifra tek raporti që ka bërë drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport, shuma 57000 euro këtu e ka cekur 42 000 për kulturë dhe 50 300 për sport del shuma 92 000. Për Kulturë, Rini dhe Sport kanë qenë 57000 euro...! Për Kultur Rini dhe Sport kanë qenë 90 000. Ndoshta jam i gabuar, nuk e di... dakort.

**Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj:** Dakort a ka diçka tjetër. Jo. Votojmë;  
**7 për, kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.**

**Pika 2; Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj:** Propozim vendim për ridestininim dhe transferimin e mjeteve nga kategoria e projekteve kapitale dhe kategoria për mallra dhe shërbime në shpenzime kapitale. Ka ndokush diçka? Po

**Drejtoresha e drejtorisë për Emergjenc Lumniye Krap**i atëher na e kemi propozim vendimin prej drejtorisë të sherbimev publike, është transfer prej mallrave dhe sherbimeve dhe ridestinin prej projekteve kapitale që do të thotë këto janë prej mbetje kapitale na kena mendu mi bart atu ku kena nevoj.

**Florentina Elezi** Deshta me dijtë për këta qentë endacakë kjo shuma a është e njëjta shumë kjo, apo çka?

**Drejtoresha Lumniye Krap**i nuk është shuma e njëjtë i kemi pasë 20.000 euro, paraprakisht prej këtij projekt propzimi i kemi kalu te mirëmbajtja e tregut na ka mbet edhe kjo shuma tjetër dhe nuk është shuma e njëjtë.

**Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**; Florentinë e këna spjegu se mjetet për qentë endacakë është në nivel qendror, është e parapare i kemi shpenzuar muajin e kaluar i kemi nda një pjesë, kanë mbetur edhe një pjesë, ti alokojmë edhe këto.

**Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj**: Dakort, a ka diçka tjetër? Jo. Votojmë;  
*7 për, kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.*

**Pika 3; Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj**; Propozim vendim për ridestinin të mjeteve nga Drejtoria për Infrastrukturë Publike, plus pikën që shtuam propozim vendim për regjistrim të mjeteve të infrastrukturës publike. Fjala për drejtorin e Infrastrukturës publike

**Drejtori i Infrastrukturës, Idriz ...** i kemi katër propozime ku me i marr këto mjete. Janë pika d asfaltimi i rrugës të fshatrave Bainc-Damanek kanë tepruar 11000 euro kemi vendosur ti dërgojmë tek rruga e Tërstenikut kanë qenë 6000 tani janë 18000, për arsye se kemi rrugën me katër korsi është gati përfundimit dhe jemi tek Gjokat, ku kjo pjesë duhet me u lidh me lisat binake, është pjesa që gjysma e Tërstenikut të ketë mundësi kycje, për të mos shkuar deri në Polluzh.

**Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj** fjala për Adelinën

**Edolina Plakiqi**; Një pyetje për drejtorin. Çdo muaj kemi ridestinine, ridestinine, por kur kanë me fillu këto projekte për zbatim?

Zëri nuk dëgjohet për kthimin e përgjigjes.

**Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj**, fjala për Burimin

**Burim Bujupi**; - Desha tu drejtohem si drejtorit dhe kryetarit. Pse po lejoni mu vendos ato shtylla në linjën e rrugës, kur prapë do ti heqim nëse kalon rruga me katër korsi?

**Kryetari Komunës, Ramiz Lladrovci**; Burim Unë vet u kam bërë vërejtje se mu po më pengon para teje kjo punë. Ata kanë marrëveshje me Ministrinë e Infrastrukturës Ata i shtijnë më thellë sa është e domosdoshme, kjo është punë e tyre, ne nuk paguajmë gjë. Këto janë investime të KEDS-it kanë leje prej tre vjetësh, e kanë planifikim. Rruga është miratuar dhe nuk do të ketë

ndryshime. Ua kam sqaruar dhe kam njoftuar hetuesinë edhe Krimet Ekonomike. Ata kanë filluar edhe sot po punojnë. KEDS-i ka buxhetin e vet. Ne si komunë nuk humbasim gjë kemi kryer detyrimet tona duke i njoftuar. Aty kanë filluar punimet për rrugën me katër korsi, andej nga është planifikuar me kompaninë që ka fituar tenderin që në vitin 2012. Ka dalë buxheti prej 600 mijë euro për këtë vit dhe sipas planifikimit 700 mijë për vitin tjetër.

**Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj:** Nëse nuk ka gjë tjetër, atëherë kalojmë në votim; *7 për, kundër s'ka, abstenim s'ka, Miratohet*

**Pika 4:** Propozim vendim për formimin e Panelit përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Barazi Gjinore. Ka pasur deri tash kohëzgjatje dhe ka kaluar afati dhe duhet zhvilluar në një farë mënyre procedurat, kjo është Organ trup i Kuvendit. Burim a kishe diçka.

**Burim Bujupi:** Lidhur me këtë pikë kryetari, kur merr fonde e ka zakon të lavdërohet, kam informata se kemi fituar një grand prej 20 000 euro në 2018 e kryetari nuk na ka njoftuar hiç. Ish dash me na tregu pak më shumë a është e vërtetë, kush ka punuar më shumë, s'kemi njoftime për këtë.

**Kryetari Komunës, Ramiz Lladrovci:** Janë për Barazi Gjinore dhe i kemi fituar në vitin 2018, por na i kanë dhënë sivjet. I kemi bërë publike, i kemi në vebfaqen e komunës. U kan dasht me fitu 55 mijë euro na janë lut me na dhanë 20 mijë, që të marrin edhe komunat e tjera po mbesin pa mjete. Se 20% të krejt buxhetit të ministrisë të NABL-së i kemi fituar na me grante që i bien diku 4 - 500 000 a 625 000 sa i këna marrë prej tyre.

**Burim Bujupi:** Atëhere i bien se punonjësja jonë që ka qenë Zahria ka punuar shumë mirë dhe në saj të punës se saj të ndershme komuna jonë i këna fituar.

**Kryetari Komunës, Ramiz Lladrovci:** Nuk është hiç e vërtetë, nuk ka të beje hiç me të. Nuk është e vërtetë, por është. për barazi gjinore. Ne kemi fituar ka të bejë me Barazi Gjinore sepse kemi 7 drejtoresha dhe 5 drejtora prandaj kemi fituar. Nuk sjellin individë fonde por është ekipa që sjell. Mos folni me fjalë të rrugës. Jemi katër komuna që kemi fituar, una, Kamenica, Ferizaj. Kush ka drejtoresha më shumë. Nuk është ashtu hiç. Ligji thotë se zyrtari për Barazi Gjinore është me koeficient 7, prandaj e kam bërë transferimin.

**Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj:** Nëse nuk ka gjë tjetër atëherë kalojmë në votim; *7 për, kundër s'ka, abstenim s'ka, Miratohet.*

**Pika 5:** Propozim vendim për formimin e komisionit për plotësim/ndryshimin e Rregullores për subvencione të Komunës së Drenasit. A ka dikush diçka? Duhet të formojmë Komision. Formim komisioni për ndryshim rregullore. Nëse nuk ka gjë votojmë; *7 për, kundër s'ka, abstenim s'ka Miratohet.*

**Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj:** kalojmë tek Pika 6: Raporti financiar i zhvillimit të buxhetit Janar - Qershor 2019.

Drejtori Shyqyri Bublaku; Sqaroi buxhetin për muajin janar – qershor për vitin 2019, kryesisht në bazë të raportit. Në fjalën e tij vijoi me shifrat ekonomike në bazë të raportit dhe problemet teknike të buxhetit.

**Edolina Plakiqi-** Këtu tek zyra Kuvendi Komunal sigurisht 146% mund me qenë gabim teknik se nuk ka mundësi me qenë 146%.

**Drejtori Buxhetit** Mundet me qenë gabim. Jo nuk është gabim se ky është buxheti i vitit 2018, por krahasimi është bërë gabim.

**Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj:** Ka dikush tjetër, jo atëherë kalojmë në votim; *7 për, kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.*

Kalojmë tek Pika 7; Plani i veprimt për implementimin e rekomandimeve të raportit për vitin 2018. E hapur për diskutim. Po, s'ka. Atëherë vijojmë me votim; *7 për, kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.*


Kalojmë tek pika 8; Propozim vendim për financimin e projektit Handikos Drenas. A ka diçka ? JO. Kalojmë në votim; *7 për, kundër s'ka abstenim s'ka Miratohet*

Kalojmë tek pika 9; Të ndryshme. Ka diçka? S'ka.

Pasi nuk pati diskutime të tjera, kryesuesi i Kuvendit, Halilaj, e mbylli mbledhjen në ora 10<sup>50</sup>.

Procesmbajtëse:

  
Zahrie Podrimqaku- Subashi

  
Kryesuesi i Kuvendit

Labinot Halilaj